



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

PROJEKT-ZBATIMI SISTEMIM ASFALTIM RRUGA E BRATOSHIT



RELACIONI TEKNIK

AUTORITETI KONTRAKTOR:

BASHKIA MALESI E MADHE

KONSULENTI;

PERMBAJTJA

INFORMACION I PERGJITHSHEM

Hyrje
Vendodhja e Objektit
Pozicioni Gjeografik i Objektit
Kushtet Klimaterike
Pershkrimi i Gjendjes Egzistuese

HARTIMI I PROJEKT ZBATIMIT

Projektimi Gjeometrik i Rruges

Te Pergjithshme
Gjeometria e Rruges

PREVENTIVI

Preventivi i Objektit me Cmime
Preventivi Memec
Analizat Teknike
Grafiku i Punimeve

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

1.1 Hyrje

Bashkia Malesi e Madhe me buxhetin e Vitit 2016 ka planifikuar te investoje ne objektin “Sistemim Asfaltim Rruga e Bratoshit” dhe per kete qellim ka autorizuar te kryhet projekti i zbatimit per ndertimin e ketij objekti.

Projekti I zbatimit mbeshetetet në: Termat e References se dhena nga Autoriteti Kontraktor.

1.2 Vendodhja e Objektit

Objekti “**Sistemim Asfaltim Rruga e Bratoshit**” ndodhet ne Rrethin e Malesise se Madhe ne territorin administrative te Bashkise se Malesise se Madhe dhe shtrihet ne verilindje te qytetit te Koplikut ne distance rreth 12 km nga Kopliku.

1.3 Pozicioni Gjeografik i Vendit.

Rruga e Bratoshit ne projekt shtrihet në Veri-Perendim te Shqiperise 42 gradë 14' gjerësi veriore dhe 19 gradë 14' gjatësi lindore, me një shtrirje territoriale prej 352 km² dhe me nje vije kufitare perimenter prej 345 km.

Rrethi I Malesise se Madhe kufizohet me rrethin e Shkodres, me liqenin e Shkodres dhe me kufirin e Malit te Zi.

Rajoni i Malesise se Madhe ka një lartësi qe varion nga 20 m mbi nivelin e detit dhe arrin deri ne 1600 m mbi nivelin e detit

Pjesa me e madhe e tij e perben fusha e Mbishkodres e cila fillon qe nga kufiri me qytetin e Shkodres dhe arrin deri ne Rrapshe, krahinen e Hotit dhe te Tamares

Klima e rajonit eshte kontinentale-mesdhetare, e thate dhe e shendetshme, dimer i ftohte dhe vere e thate dhe e ngrohte.

Temperatura mesatare vjetore eshte 10.6 grade C. Muaji me me shume rreshje eshte nentori me 104.9 mm. Mbizoterojne ererat veriore dhe jug-perendimore.

Zona e mare ne studim është ndërtuar kryesisht në formacione shkembore të mbuluara nga shtresa me përshkueshmëri të ulët.

1.4 Kushtet Klimatike

Veçoritë klimatike të kesaj zone kushtëzohen nga lartësia e konsiderueshme mbi nivelin e detit, nga malet në pjesën lindore, nga largësia te madhe prej detit dhe sidomos nga ndikimi i lugines se Rrapshe ne, në veri-lindje të Koplikut.

1.5 Pershkrimi i Gjendjes Egzistuese

Fillimi i projektit tone sipas gjurmes se miratuar nis tek qendra e Bratoshit atu ku ndodhet dhe shkolla dhe pikersiht eshte shkolla ajo qe tregon dhe fillimin e rruges. Nga drejtimi i

Zagores dhe deri ketu rruga eshte rikonstruktuar vitet e fundit dhe eshte e asfaltuar , ka gjeresi 3 m shtresat asfaltike dhe ne pergjithesi eshte ne gjendje te mire.
Megjithate verejme se rruga ka nevojë për mirambajtje

Gjendja egzistuese e objektit

Gjendja e Rruges egzistuese nga progresivi km 0.00 deri dhe ne progresivin km 6+600 m perbehet nga nje gjurme rruge trase e germuar e cila duke qene ne shtresa te forta shkembore ka krijuar tashme nje qendrushmeri persa i perket fortesise se saj.

Gjeresia e trasese varion nga 3- 4 m dhe ne disa raste deri ne 5 ose 6 ml.

Ne dy anet e trasese pothuajse ne gjithe gjatesine e saj ka te nderuara gardhe apo mure guri qe rrethojne pronat te cilat ne nje fare menure kane ngushtuar ate dhe kane penguar derdhjen e ujrave pergjate anesoreve te trasese duke bere qe ato te rrujedhin pergjate saj dhe ne diasa vende te krijohen dhe gropa qe ne periudhe rreshjesh mbushen me uje duke veshtiresuar kalimin normal te mjeteve.



Fillimi i rruges



shkolla e fshatit







Open
Procurement
Albania

2. HARTIMI I PROJEKT - ZBATIMIT

2.1 Projektimi Gjeometrik i Rruges

2.1.1 Te Pergjithshme

Segmenti Rrugor Rruga e Bratoshit eshte pjese e nje segmenti mjaft te rendesihem per zonen te aksit rrugor I cili lidhe Koplkun- Zagoren- Bratoshin me Rrapshen dhe rrugen nacionale Hani I Hotit-Vermosh.

Per gjendjen e saj dhe pamundesite financiare te ndertimin te kopmplet gjatesise prej 6.6 km projekti ka parashikuar rehabilitimin sistemin dhe asfaltimin e nje segmenti prej 2 km.

Kjo rruge, për nga rëndësia dhe intesiteti parashikohet të jetë rrugë kryesisht per trafik te tonazhit të lehte dhe te mesem.

Duke qene se rruga ka gjeresi 3-4 m jane parashikuar dhe nednderrime per mjetet e qarkullimit te cilat jane parashikuar ne cdo 200-300 ml por ne raste tjera ne vende qe shikojne njera tjetren ne menyre qe automjetet te kene mundesine te nderrohen me njeri tjetrin pa veshtiresi.

Ajo do të këtë njekohësisht disa funksione:

- Do i shërbejë zhvillimit urban të zonës duke qënë nje nga arteriet kryesore qe kalon ne kete zone te banuar dhe duke bere lidhjen e Zagores dhe fshatrave siper tij me rrugen kombetaret hani I Hotit-Vermosh.
- Do i sherbeje rritjes dhe zhvillimit te metejshem te ekonomise se banoreve te zones dhe turizmit ne zonen turstike te Zagores Bratoshtit dhe Rrapshes.
- Do i sherbeje blegtoveve te zones per te nxjerre ne treg produktet blegtorale ne nje kohe sa me te shkurter.


Gjate gjithë gjatesise se rruges ne kthesa jane parashikuar te behen zgjerime qe te arrihen parametrat gjeometrike te kerkuar, duke bere permiresimet e mundshme ne funksion te zones dhe distancave te objekteve.

2.1.2 Gjeometria e Rruges

Kategoria e Rruges

Bazuar ne termat e references dhe ne perafrim me Rregullin Teknik te Projektimit te Rrugeve miratuar ne 2015 ,(megjithese ky regull nuk eshte i detyrueshem per zbatim nga investimet e pushtetit lokal) Rruga e Recit duhet te projektohet si rruge e kategorise F me ndryshim ;

1x 3 m (pjese e asfaltuar) + 2 x 0.5 m (bankina me stabilizant me gjeresi totale 4 m.



Elementet e tjere jane:

Shpejtesia e projektimit sipas terenit:

- | | |
|-------------------------|---------------------------------|
| - terren fushor | $V_{proj} = 30 \text{ km/ore}$ |
| - terren kodrinor malor | $V_{proj} = 20 \text{ km /ore}$ |

Zgjerimi ne Kthese

Zgjerimi ne kthese eshte patur parasysh per te gjitha kurbat rrezja e te cilave eshte me e vogel se 150 m.

Duke patur parasysh konkluzionet dhe te dhenat e mesiperme zgjidhja e propozuar konsiston ne :

Konkluzion

Bazuar ne sa me siper , gjurma e propozuar nga pikpamja gjeometrike respekton parametrat e nje rruge fushore te kategorise F (modifikuar) me shpejtesi $V = 20\text{-}30 \text{ km/ore}$

Hartimi i Projekt – Zbatimit u bazua ne Studimet gjeologjike te hartuara me pare per kete segment rrugor dhe per gjithë zonen ne pergjithesi, Studimin Topografik, Studimin Hidrologjik mbeshetur ne studimin e pergjithshem te zones si dhe ne studimin per rritjen e trafikut mbeshetur ne studimin e fizibilitetit te rjetit rrugor te Malesise se Madhe.

Zgjidhjet e dhena nga Konsulenti:

Per te gjithë gjatesine rruges

1. $L = 2000 \text{ m}$
2. Gjeresi = $3 \text{ m (seksion i asfaltuar)} + 2 \times 0.50 \text{ m (bankine)} = 4 \text{ m}$
3. Paketa e shtresave (shiko profilat terthor tip):
 - Shtrese binderi 6 cm
 - Shtrese stabilizanti per trasene 10 cm
 - Shtrese stabilizanti per bankina 10 cm
 - Nivelim me cakull ose zhavor dhe mbushje gropa

Vepra arti nuk jane parashikuar

Metodologjia e kryerjes se punimeve.

Metodologjia dhe radha e kryerjes se punimeve do te jete gjithnje ne zbatim te vizatimeve te projektit, matjeve topografike te realizuara ne fillimin e punimeve, specifikimet teknike dhe ne zerat e percaktuara ne listen e preventivit.

Procedura e sistemimit dhe asfaltimit te shtresave rrugore te ketij aksi do jete sipas kesaj radhe; do filloje nivelimi i shtreses ekzistuese me cakull ose zhavor dhe patrimi nga ferrat bimesia apo mbetjet e ndryshme ne gjithë gjeresine e trupit te rruges.

Ne vende ku pjerresia per distance te shkuirter eshte e larte do behet rregullimi i niveletes me shtrese cakulli te ngjeshur.

Me pas vijohet me shtresat e stabilizantit Shtresa e stabilizantit prej 10 cm do te shtrihet ne te gjithë trasene e rruges prej 4 m. Me pas do te hidhet shtresa e binderit dhe te ngjshet ajo deri ne kompaktësimine plote sipas standarteve te miratuara dhe specifikimeve bashkengjitura.

Parashikohen dhe vendosje e tablevae treguese.

3.PREVENTIVI

4.SPECIFIKIME TEKNIKE

Grupi projektues

Ing Simon PRENDI

Ing Myfit BALA

Ing Arjan DANA

